



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilaški Savet Kosova / Kosovo Prosecutorial**  
**Council**

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 paragrafi 1.27 të Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 83 publikuar me dt. 29 tetor 2010) dhe të neneve 16 dhe 36 të Ligjit Nr. 05/L-030 për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 18e publikuar me 13 korrik 2015), në takimin e mbajtur më 27 maj 2016 miraton:

**RREGULLORE Nr. 05/2016**

**për Njësinë Ndërlidhëse për Përgjimet**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Kjo rregullore përcakton funksionimin e Njesisë Ndërlidhëse për Përgjimet në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, procedurat në procesin e përgjimit ligjor, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve të autorizuar për zbatimin e procedurës së përgjimit duke u mbështetur në standarde të larta profesionale dhe zbatimin me sukses të masave të fshehta të përgjimit.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

Kjo Rregullore zbatohet nga të gjitha institucionet e autorizuar, kompetente për të zbatuar përgjimin, nga të gjithë ofruesit e rrjetit ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të autorizuar nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare si dhe Qendrat Monitoruese.

**Neni 3**  
**Vula e Njesisë Ndërlidhëse për Përgjimet**

1. Njësia Ndërlidhëse për Përgjimet ka vulën e protokollit e cila bëhet në pajtim nenin 3 dhe 11 të Ligjit për Përdorimin e Vulave në Institucionet e Republikës së Kosovës.

2. Vula e Njesisë Ndërlidhëse ka formë katrore-protokollare me madhësi 40-60 mm, me mbishkrimin si në vijim:

- 2.1 Republika e Kosovës/Republika Kosova
- 2.2 Prokurori i Shtetit/Drzavni Tuzilac/
- 2.3 Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit/Kancelarija Glavnog Drzavnog Tuzioca
- 2.4 Njësia ndërlidhëse/Jedinica za vezu
- 2.5 Pranuar/Primljeno
- 2.6 Numri rëndor/Redni Broj
- 2.7 Ora e pranimit/Cas prijema dhe
- 2.8 Nënshkrimi i pranuaesit/Potpis primaoca

#### Neni 4 Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

“KPK” .....	Këshilli Prokurorial i Kosovës;
“ZKPSH” .....	Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit;
“KPK” .....	Kodi Penal i Republikës së Kosovës;
“KPPK” .....	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës;
“Njësia Ndërlidhëse”	Vendndodhja fizike e pajisjeve teknike nën administrimin dhe kontrollin e Kryeprokurorit të Shtetit, të përcaktuara në Nenin 15 të Ligjit Nr. 05/L-030 për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike;
“Objekt Përgjimi”	Janë sinjalet, shkrimet, fotografitë, të dhënat audiovizuele ose lloj tjetër informacioni, për tu marrë ose transmetuar nëpërmjet pajisjeve të komunikimit elektronik;
“ARKEP” .....	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare;
“ASHMDHP”	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
“AKI” .....	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë;
“KMPP” .....	Komisionari për Mbikëqyrje të Procedurës së Përgjimeve të Komunikimeve Elektronike;
“TI” .....	Teknologjia Informative.

#### Neni 5 Parimet e punës në Njësinë Ndërlidhëse

Puna e Njesisë Ndërlidhëse bazohet në parimin e respektimit të të drejtave të njeriut, respektimit të sekretit dhe urdhrimit të ligjshëm.

#### Neni 6 Njësia Ndërlidhëse për Përgjimet

1. Njësia Ndërlidhëse për përgjimet (këtu e tutje: Njësia Ndërlidhëse) është pajisje teknike të teknologjisë informative e cila aktivizon dhe ndalon përgjimin e një

pajisje fundore pas Urdhrit të ligjshëm për përgjim të lëshuar nga Gjykata kompetente ose Urdhrit të përkohshëm të prokurorit.

2. Njësia Ndërlidhëse mirëmbanë regjistrat e aktivizimeve të përgjimeve të cilët regjistra ruhen në pajtim me legjislacionin sekondar të Këshillit Prokurorial të Kosovës (këtu e tutje "KPK") në konsultim edhe me institucionet si Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (këtu e tutje "ASHMDHP"), Autoritetin Rregullativ të komunikimeve elektronike dhe postare (këtu e tutje "ARKEP").
3. Njësia Ndërlidhëse si pajisje teknike është e vendosur në ndërtesën e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe hapësira ku është vendosur Njësia Ndërlidhëse garanton sigurinë e plotë të informacionit të marrë gjatë realizimit të përgjimit.

#### **Neni 7**

#### **Themelimi i Njesisë Ndërlidhëse**

1. Kryeprokurori i Shtetit me vendim themelon brenda Zyrës së tij Njësinë Ndërlidhëse bazuar në Ligjin Nr. 05/L-030 për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike dhe këtë Rregullore.
2. Kryeprokurori i Shtetit administron dhe kontrollon Njësinë Ndërlidhëse dhe mund të caktojë një prokuror i cili udhëheqë me Njësinë Ndërlidhëse në emër të tij.
3. Kryeprokurori i Shtetit me qëllim të funksionimit të Njesisë Ndërlidhëse cakton zyrtarët administrativ të cilët angazhohen në Njësinë Ndërlidhëse.

#### **Neni 8**

#### **Procedura e përgjimit**

1. Njësia Ndërlidhëse ekzekuton teknikisht përgjimin vetëm me urdhër të gjyqtarit të Gjykatës kompetente.
2. Përjashtimisht në raste të caktuara, Njësia Ndërlidhëse ekzekuton urdhëresat e përkohshme të prokurorit të shtetit të përcaktuara me nenin 91 parag. 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (këtu e tutje "KPPK") vetëm në rrethanat a parapara në këtë dispozitë të KPPK.
3. Urdhri nga paragrafi 2 i këtij neni pushon të ketë efekt në rastet kur nuk konfirmohet me shkrim nga gjyqtari i procedurës paraprake tri (3) ditë nga lëshimi i tij.
4. Urdhëresat e lëshuara nga organet kompetente duhet të jenë në përputhje të plotë me dispozitat e KPPK dhe duhet të përmbajë:

- 4.1 Obligimet për zyrën Prokurorit të Shtetit, Operatorët e Rrjetit dhe/ose Ofruesit të Shërbimeve, si dhe Sektorit për Përgjim;
- 4.2 Institucionin që ka bërë kërkesën;
- 4.3 të dhënat personale dhe adresën e subjektit që i nënshtrohet masës së përgjimit nëse janë të njohura;
- 4.4 numrin e protokollit;
- 4.5 afatin ose afatet e përgjimit, ku përcaktohet data dhe ora e fillimit dhe e mbarimit;
- 4.6 operatorin e telekomunikacionit që siguron komunikimin;
- 4.7 pajisjet fundore që përdor subjekti i përgjimit për realizimin e komunikimeve elektronike; dhe
- 4.8 arsyetimi që vërtetojnë se përgjimi është i domosdoshëm dhe së të dhënat që kërkohen nuk mund të sigurohen me mjete të tjera të hetimit apo mbledhje së informacionit.

#### **Neni 9 Pranimi i Urdhëresave**

1. Urdhëresat sillen nga zyrtari i autorizuar në Njësinë Ndërlidhëse në kuvertë të mbyllur me mbishkrimin >SEKRET<. Dokumenti përmban Urdhëresën, Udhëzimin dhe Fletë pranim-dorëzimit (Shtojca 1).
2. Prokurori i autorizuar nga ana e Kryeprokurorit të Shtetit fillimisht e pranon Urdhëresën në bazë të së cilës kërkohet ekzekutimi teknik i masës së fshehtë të përgjimit.
3. Prokurori i autorizuar pas kontrollimit preliminar të Urdhëresës dhe pas konstatimit se Urdhëresa i plotëson kushtet e parapara ligjore e pranon të njëjtën.
4. Pas pranimit të Urdhëresës, prokurori i autorizuar e përcjellë udhëzimin te zyrtari i caktuar administrativ i cili do të ndihmojë në zbatimin e Urdhëresës.
5. Zyrtari i autorizuar pas pranimit në Njësinë Ndërlidhëse të fletë pranim-dorëzimit (Shtojca 1) dhe Udhëzimin ose kopjen e Urdhëresës obligohet të njëjtën ta dorëzojë në Qendrën Monitoruese.

#### **Neni 10 Regjistrimi dhe ruatja e Urdhëresës**

1. Kryeprokurori i Shtetit cakton një zyrtar ligjor i cili nën mbikqyrjen e prokurorit përgjegjës regjistron Urdhëresën dhe Udhëzimin dhe i protokolon me vulën e Njësisë Ndërlidhëse.
2. Zyrtari ligjor mban regjistrin e Urdhëresave të pranuar nga ai me të dhënat në vijim të paraqitur në Shtojcat 1, 2 dhe 3 të kësaj Rregullore.

3. Zyrtari ligjor pas regjistrimit të Urdhëresës i përcjellë zyrtarëve të TI udhëzimin me të dhënat për ekzekutimin e Urdhëresës, pranimi dorëzimi i këtij udhëzimi bëhet sipas Shtojcës 2 dhe 3.

#### **Neni 11**

#### **Struktura organizative e Njesisë Ndërlidhëse**

1. Njësia Ndërlidhëse ka këtë strukturë organizative:
  - 1.1 Kryeprokurori i Shtetit ose prokurori i caktuar nga ana e tij;
  - 1.2 Zyrtari ligjor për pranimin dhe protokollimin e Urdhëresave dhe Udhëzimeve, dhe
  - 1.3 Zyrtarët i TI për ekzekutimin teknik të masës së përgjimit.

#### **Neni 12**

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Prokurorit të autorizuar në Njësinë Ndërlidhëse**

1. Prokurori i autorizuar në Njësinë Ndërlidhëse është përgjegjës:
  - 1.1 Të administrojë dhe kontrollojë Njesisë Ndërlidhëse, duke garantuar sigurinë e plotë të regjistrave të aktivizimeve të përgjimeve dhe fshehtësinë e tyre.
  - 1.2 Të mundësojë dhe lehtësojë procesin e përgjimit në Qendrat Monitoruese të vendosura në Policinë e Kosovës (këtu e tutje "PK") dhe Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë(këtu e tutje "AKI").
  - 1.3 Të krijojë kapacitete të nevojshme teknike dhe organizative për zbatimin e përgjimeve paralele të shumëfishta.
  - 1.4 Të pajtohet me legjislacionin sekondar të lëshuar nga ARKEP lidhur me standardet teknike lidhur me përgjimet paralele dhe për numrin maksimal të përgjimeve paralele.
  - 1.5 Të pranojë Urdhëresat për përgjimet.
  - 1.6 Aprovon qasjen në dhomat e Njesisë Ndërlidhëse kur kërkohet nga operatorët qasja për servisimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve.
  - 1.7 Të mbikqyrë stafin administrativ të punësuar në Njësi, dhe
  - 1.8 Të bashkëpunojë me organet publike me qëllim të efikasitetit me rastin e zbatimit të urdhëresave për përgjim, e në veçanti të bashkëpunojë me sektorin e përgjimit në policinë e Kosovës dhe AKI.

#### **Neni 13**

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit Ligjor**

1. Detyra dhe përgjegjësitë e Zyrtarit Ligjor të Njesisë Ndërlidhëse janë si në vijim:
  - 1.1 Regjistrimi dhe protokollin e Urdhëresave të pranuar nga prokurori i caktuar;
  - 1.2 Mbatja e regjistrave të Urdhëresave të pranuar;
  - 1.3 Përcjellja e udhëzimit tek zyrtarët TI për të ekzekutuar Urdhrin për përgjim;
  - 1.4 Përgatitja e raportit të punës dhe

1.5 Kryen edhe detyra te tjera te ngarkuara nga prokurori i autorizuar.

#### **Neni 14**

##### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit për administrimin teknologjisë**

1. Detyra dhe përgjegjësitë e Zyrtarit për administrimin e teknologjisë janë:
  - 1.1 Mbikëqyrja dhe menaxhimi i pajisjeve të vendosura në Njësine Ndërlidhëse;
  - 1.2 Ekzekuton udhëzimet pranuar nga zyrtari mbikëqyrës;
  - 1.3 Menaxhimi i terminaleve menaxhuese që mundëson regjistrimin e përgjimeve;
  - 1.4 Administrimi, analizimi dhe mirëmbajtja e sistemit të përgjimit elektronik;
  - 1.5 Kontrollimi i mbarëvajtjes së punës së serverëve dhe pajisjeve tjera të përgjimit dhe mënjanimit të problemeve të paraqitura;
  - 1.6 Administrimi i rrjetit LAN dhe WAN;
  - 1.7 Projektimi, administrimi dhe mirëmbajtja e sistemit të video vëzhgimit;
  - 1.8 Në kontrollin tij/saj bëhet intervenimi i pajisjeve nga operatorët (sipas nevojës së paraqitur);
  - 1.9 Kryen edhe punë tjera të profesionale, sipas nevojave dhe kërkesës të zyrtarit mbikëqyrës.

#### **Neni 15**

##### **Verifikimi i personelit dhe objektit të Njesisë Ndërlidhëse**

1. Zyrtarët administrativ të punësuar në Njësine Ndërlidhëse duhet të kenë verifikim sigurie nga Autoriteti Verifikues i AKI.
2. Objektet dhe të gjitha pajisjet që instalohen për qëllime të përgjimit duhet të kenë verifikim të sigurisë nga Autoriteti Verifikues se a janë në përputhje me kërkesat teknike dhe të sigurisë të përcaktuara me akte nënligjore nga ARKEP.
3. Qasja në hapësirat e Njesisë Ndërlidhëse është e kufizuar dhe u lejohe vetëm zyrtarëve të autorizuar nga Kryeprokurori i Shtetit ose i autorizuari i tij. Në rastet kur në mjediset e Njesise Nderlidhese duhet të hyn personat qe nuk janë punonjës të Njesisë ata përveq autorizimit që duhet të marrin nga Kryeprokurori i Shtetit apo i autorizuari i tij, të njëjtit duhet të shoqërohen nga prokurori i autorizuar gjatë gjithë kohës.
4. Personat e autorizuar evidentohen në regjistrin përkatës, në të cilin pasqyrohen emri dhe mbiemri, funksioni, data, ora e hyrje-daljes dhe arsytet. Ky regjistër administrohet nga Prokurori përgjegjës.

**Neni 16**  
**Fshehtësia e informacioneve**

1. Informacionet e siguruar nga përgjimi, në tërësi ose në veçanti përbën sekret që nënkupton se informatat duhet të mbeten të fshehta dhe të mos vihen në dispozicion të publikut dhe personave të paautorizuar.
2. Kushdo që pa autorizim zbulon informacionin konfidencial për të cilin është vënë në dijeni gjatë regjistrimit apo përgjimit do të përgjigjet penalisht sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës (këtu e tutje: KPK).

**Neni 17**  
**Orari i punës**

1. Njësia Ndërlidhëse përmes zyrtarëve kujdestarë do të jetë në shërbim sipas nevojës 24 orë në ditë shtatë ditë në javë.
2. Në rastet emergjente, pas orarit të rregullt të punës, në fundjave apo ditëve të festave zyrtare, prokurori i autorizuar ngarkon njërin nga zyrtarët që të jetë në dispozicion për të asistuar në aspektin teknik të përgjimit.
3. Institucionet e autorizuara do të kenë në dispozicion numrin kontaktues mobil të zyrtarit të caktuar në kujdestari në Njësinë Ndërlidhëse.

**Neni 18**  
**Obligimi i operatoreve të komunikimeve elektronike**

1. Operatorët e komunikimeve elektronike obligohen në furnizimin dhe instalimin e gjitha pajisjeve të nevojshme të TI -së, të cilat do të përdoren për funksionalizimin e përgjimeve të komunikimit elektronik në Njësinë Ndërlidhëse.
2. Operatorët e komunikimit elektronik obligohen në mirembajtjen dhe servisimin e paisjeve të TI-së, të vendosura në Njësinë Ndërlidhëse.
3. Kur operatorët bëjnë përmisimin e teknologjive, detyrohen të mbulojnë me shpenzimet e veta vazhdueshmërinë e funksionimit të procesit të përgjimit.
4. Ndryshimet apo perditësimet që mund të kenë efekte në procesin e përgjimit të komunikimeve elektronike duhet të paralajmërohen paraprakisht brenda 30 ditë pune.

**Neni 19**  
**Numri testues**

1. Prokurori i autorizuar si përgjegjës për Njësinë Ndërlidhëse siguron një numër testues i cili do të evidentohet në emër të Njësisë Ndërlidhëse përmes të cilit do të testohet funksionimi i pajisjeve për përgjim.
2. Numri testues duhet të blihet nga buxheti i KPK-së, dhe nuk duhet të ketë qenë më parë i përdorur.

**Neni 20**  
**Gabimet Teknike**

1. Zyrtari i autorizuar për futjen e të dhënave në sistem, nëse vëren se e dhëna është futur gabimisht, duhet ta njoftojë menjëherë prokurorin e autorizuar për gabimin e ndodhur dhe me miratimin e tij ta përmirësojë gabimin dhe për rastin të hartojë një shënim zyrtar.
2. Shënimi zyrtar nga parag. 1 i këptij neni duhet të përmbajë të dhënat në vijim:
  - 2.1 Data dhe koha e ndodhjes së gabimit;
  - 2.2 Numri i protokollit të Udhëzimit për përgjim, dhe
  - 2.3 Përshkrimi i rastit.
3. Nëse e dhëna e gabuar është transferuar në Qendrën Monitoruese, atëherë prokurori i autorizuar e njofton zyrtarin kompetent në Qendrën Monitoruese, me rastin me shënim zyrtar.

**Neni 21**  
**Kompenzimi**

1. Prokurori i autorizuar si përgjegjës për Njësinë Ndërlidhëse ka të drejtë në kompenzim shtesë cili nuk mund të kalojë 25% të pagës bazë të tij. Vendimin lidhur me shumën e kompenzimit e merr KPK.
2. Personeli administrativ do të rekrutohet në bazë të Ligjit për Shërbimin Civil, pagat dhe kategorizimi i tyre do të bëhet nga Drejtori i Sekretariatit të KPK-së.
3. Personeli administrativ ka të drejtë në kompenzim shtesë për mbajtjen e kujdestarisë, i cili do të caktohet me vendim të KPK-së.

**Neni 22**  
**Dispozitat kalimtare**

Operatorët e rrjetit dhe ofruesit e shërbimeve obligohen që të dhënat e mbledhura dhe të ruajtura t'i vënë në dispozicion të Njësisë Ndërlidhëse për një periudhë prej nëntë (9) muajve pas funksionalizimit të saj.



**Neni 23**  
**Hyrja në Fuqi**

Kjo Rregullore hynë në fuqi pas miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Prishtinë më: 27 maj 2016

Blerim Isufaj

Kryesues  
Këshilli Prokurorial i Kosovës

